



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr-4- *111-41779*

Datë: 02.08.2016.

Në bazë të nenit 16 dhe 62 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës neni 5 pika C dhe Statutit të Komunës, Drejtoria e Arsimit në Lipjan, shpall:

KONKURS

Për vend të lirë pune - Shofer (vozitës) autobusi në Slllovi

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron shërbime të vozitjes për nxënësit e shkollës Shfmu "Hasan Zyko Kamberi" në Slllovi,
- Vozitësi duhet të jetë në gjendje që të kryen riparime të vogla dhe siguron që automjeti të jetë i pastër dhe në gjendje të mirë,
- Mbajtja e librit të shënimeve për kilometrazhin e automjeteve, të riparimeve, licencave dhe lejeve, si dhe dokumentacioneve të tjera,
- Është përgjegjës për dëmet e shkaktuara në automjet nga pakujdesia apo mospërshtatja e kushteve të komunikacionit,
- Sigurohet që të gjitha veprimet të jenë në pajtim me rregullat dhe rregulloret në rastin e përfshirjes në aksident/incident trafiku,
- Kryerja e detyrave të tjera zakonisht të caktuara për vozitësin.

Kriteret dhe kushtet e nevojshme :

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- Kandidati duhet të ketë patentë shoferi valid (të vlefshëm), kategoria D,
- Kandidati duhet të jetë në gjendje të punojë me orar fleksibil të punës,
- Dëshmi se nuk është nën hetime.

Aplikacionet merren në Arkivin komunal dhe dorëzohen në të njëjtën zyre, bashkë me dokumentet për konkurim.

Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen.

Dokumentet e pranuar nuk kthehen.

Afati dhe mënyra e aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes, duke filluar nga **03.08.2016** gjerë më **17.08.2016**

